

**Kushtet e punës (KP)**  
**për ekspertin afatshkurtër të politikës lokale**

## **1. Informata hyrëse**

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ dhe NALED nënshkruan Kontratën për implementimin e projektit **“Krijimi i një platforme për ambient të favorshëm të biznesit (AFB) në BP6”** (në tekstin e mëtejshëm: Projekt) në nëntor të vitit 2021.

Gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, përkatësisht Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, vazhdojnë të shprehin përkushtimin e tyre ndaj procesit të integritimit në BE dhe përpiqen të ndërmarrin reforma në fusha të ndryshme që do të lehtësonin përputhjen e tyre me BE-në dhe standardet ndërkombëtare. Strategjia e zgjerimit të BE-së për “Një perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe angazhim të zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor” pranon se të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida në lidhje me rritjen ekonomike dhe konkurrencën.

Megjithatë, edhe pse ekziston një interes i qartë për harmonizimin e politikave dhe partneritetin rajonal për të nxitur zhvillimin ekonomik, mekanizmat funksionalë për dialogun shumë-palësh dhe shumë-sektorial për të harmonizuar politikat dhe për të shkëmbyer praktikat më të mira për të nxitur rritjen ekonomike në nivel kombëtar dhe lokal nuk janë krijuar ende (**problem thelbësor**).

Nga ana tjetër, mekanizmi i krijuar që nga viti 2012 nga Rrjeti i Certifikimit të Favorshëm të Biznesit në Evropën Juglindore (BFC SEE) ka arritur rezultate të jashtëzakonshme në drejtim të përmirësimit të ambientit të biznesit në ekonomitë pjesëmarrëse të Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë. Që nga themelimi i tij, rrjeti BFC SEE ka përmirësuar shërbimet e ofruara për bizneset në mbi 60 komuna nga Ballkani Perëndimor (me përjashtim të Kroacisë).

Me kapitalizimin e rezultateve të rrjetit ekzistues BFC SEE, ekziston **mundësia** për të shfrytëzuar vullmin e nevojës ekzistuese për zhvillim të fuqishëm ekonomik dhe një ambient të përmirësuar të volitshëm ndaj biznesit, dhe për të siguruar mbështetje për kapacitetet e pazhvilluara të rajonit për të hartuar dhe zbatuar reformat e kërkuara si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal.

Kështu, nën-projekti propozon që të shfrytëzohen këto potenciale, gjegjësisht kërkesa për bashkëpunim më të ngushtë dhe korniza e krijuar në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, si dhe praktika e mirë e vendosur në rrjetin BFC SEE. Kështu, **qëllimi** i projektit është krijimi i një mekanizmi efikas për bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e njohurive për zbatimin e proceseve reformuese për rritjen ekonomike edhe në nivel kombëtar edhe në nivel lokal.

Projekti ka për qëllim të arrijë krijimin e mekanizmave për shkëmbimin e praktikave për zhvillimin ekonomik në rajon dhe një kulturë partneriteti ndërmjet palëve të interesuara për zhvillimin ekonomik që përfaqësojnë sektorin publik, privat dhe civil. Me këtë rezultat të pritur, nën-projekti kontribuon ekskluzivisht për arritjen e Objektivit 17: Rigjallërimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm, sepse një agjendë e suksesshme për zhvillim të qëndrueshëm kërkon partneritete ndërmjet qeverive, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Përveç kësaj, duke mbështetur zhvillimin ekonomik lokal të komunave në Ballkanin Perëndimor, projekti gjithashtu kontribuon për arritjen e Objektivit 8: Promovimi i rritjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimi dhe puna e denjë për të gjithë, si dhe të Objektivit 11: Bërja e qyteteve gjithëpërfshirëse, të sigurta, rezistente dhe të qëndrueshme.

Më e rëndësishmja, projekti promovon bashkëpunimin rajonal midis palëve të interesuara për zhvillimin ekonomik dhe jep një kontribut të dukshëm në zbatimin e agjendës së zhvillimit ekonomik të BE-së.

NALED vepron si Sekretariat Teknik Rajonal. Partnerët/sekretariatet teknike për zbatimin e projektit janë: Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në Maqedoninë e Veriut (BNJVL), Oda Ekonomike në Mal të Zi, Oda Ekonomike në Republikën Sërpska, Instituti Hulumtues RIINVEST Kosova\*, Shoqata për Autonomi Lokale në Shqipëri dhe Agjencia për Zhvillimin Rajonal REDAH nga Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës.

### **Objektivi i projektit**

Është krijuar një mekanizëm efikas për bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e njohurive për zbatimin e proceseve reformuese për rritjen ekonomike edhe në nivel kombëtar edhe në nivel lokal.

### **Qëllimi i projektit**

Kushtet për zhvillimin komunal dhe zhvillimin ekonomik lokal në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë përmirësuar në përputhje me kërkesat për anëtarësim në BE.

### **Pasqyra e roleve të sekretariateve teknike (rajonale)**

NALED, si Sekretariat Teknik Rajonal i Programit BFE, do të angazhojë ekspertin kryesor të politikave për ambientin e favorshëm të biznesit dhe ekspertin kryesor ligjor për ambientin e favorshëm të biznesit. Këta ekspertë do të mbështesin sekretariatet teknike dhe ekspertët e tyre të politikave lokale në identifikimin e reformave, përgatitjen e prospekteve dhe drafteve për reformat e përzgjedhura dhe përpjekjet e avokimit në ekonomitë e tyre.

Çdo sekretariat teknik do të angazhojë një ekspert të politikave lokale për të mbështetur identifikimin e reformave, për të përgatitur një prospekt dhe drafte të reformave dhe për të punuar me sekretariatit teknik në procesin e avokimit.

Zgjedhja e reformave që do të futen në ekonomitë do të bëhet nga Këshilli Rajonal (Autoriteti Menaxhues për Partneritetin CORE i cili përbëhet nga përfaqësuesit e gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor - WB6).

### **Rezultati i pritur i detyrës**

Reforma të identifikuara të suksesshme për një ambient të përmirësuar biznesi, një prospekt të përgatitur dhe drafte të reformave të identifikuara dhe procese të iniciuara avokimi me autoritetet relevante në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor.

## **2. Vëllimi i detyrës së ekspertit**

Eksperti do të ketë për detyrë të ndihmojë sekretariatit teknik në kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse të reformave në shtetit, të cilat janë zbatuar për të kontribuar për mundësimin e një ambienti të favorshëm biznesi. Eksperti do të bashkëpunojë ngushtë me ekspertin kryesor të politikave dhe ekspertin kryesor ligjor të angazhuar nga NALED.

Eksperti do të shqyrtojë reformat që janë cilësuar si të rëndësishme nga organet publike, bizneset dhe shoqëria civile, të cilat nga ana tjetër kanë pasur ndikim në lehtësimin e të bërit biznes ose kanë ndikuar ndaj pozicionit të ekonomisë së tyre në indekset e konkurrencës të njohura ndërkombëtarisht. Reformat mund të ndryshojnë sipas vëllimit të tyre, kështu që eksperti do të shqyrtojë vetëm reformat që janë zbatuar në nivelin më të lartë të qeverisjes në ekonominë e tyre, me përjashtim të reformave të zbatuara në nivelin lokal të qeverisjes.

Puna do të përbëhet nga zbatimi i një vlerësimi bazë të reformave, duke identifikuar ato që kanë pasur ndikimin dhe/ose dukshmërinë më të rëndësishme. Pas identifikimit të reformave, eksperti do të ketë për detyrë të analizojë reformat duke përdorur një metodologji gjithëpërfshirëse (shih më shumë në Metodologji) për të zgjedhur 3-5 më të rëndësishmet në marrëveshje me sekretariatit teknik dhe NALED dhe për të përgatitur një prospekt për to. Pasi reformat të përzgjidhen nga Këshilli Rajonal, eksperti do të hartojë drafte për 1-3 reforma që janë dëshmuar se kanë një ndikim të rëndësishëm dhe konsiderohen si shembuj të praktikës më të mirë, kështu që ato me siguri do të mund të zbatoheshin në gjashtë ekonomitë e tjera të Ballkanit Perëndimor. Së fundi, eksperti do të sigurojë mbështetje eksperte për sekretariatit teknik dhe ekspertin kryesor të politikave në konsultime me palët e interesuara relevante për qëllimet e avokimit të reformave.

### **2.1. Dërgesat e pritura të shërbimeve**

Eksperti do t'i sigurojë këto dërgesa të shërbimeve gjatë angazhimit të tij:

- ▶ Raport për hulumtimin e zbatuar në zyrë, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, listën me 10-20 reforma dhe broshurat reformuese (prospekt) për 3-5 reforma të zgjedhura të cilat duhet të zbatohen edhe në ekonomitë e tjera;
- ▶ Drafte reformuese për 1-3 reforma të praktikave më të mira me qëllim që ato të "importohen" nga ekonomi të tjera;
- ▶ Raport për procesin e zbatuar të avokimit.

### **2.2. Detyrat konkrete**

Eksperti është paraparë të kryejë detyrat që vijojnë:

#### **Detyra 1: Faza fillestare dhe përgatitja e listave dhe prospekteve**

- ▶ Të marrë pjesë në mbledhjen fillestare me përfaqësuesit e të gjitha sekretariateve teknike dhe ekspertë për politika;
- ▶ T'i identifikojë dhe analizojë reformat e praktikave më të mira në bashkëpunim me sekretariatit teknik dhe ekspertin kryesor të politikave;
- ▶ Të bëjë analizë të detajuar të dokumenteve. Në këtë detarë, eksperti pritet të analizojë:
  - Raporte për vendin dhe raporte për indeksin ndërkombëtar të konkurrencës,
  - Deklaratat ex-post dhe ex-ante për vlerësimin e ndikimit të rregullores, të përgatitura për mjetet e zbatimit të një reforme të caktuar (miratimi i rregulloreve të reja ose të ndryshuara),
  - Studime dhe dokumente të tjera analitike që theksojnë hapat proceduralë, kërkesat ligjore dhe karakteristikat e tjera të reformave të analizuara,
  - Dokumente dhe rregullore për politikat publike që kanë të bëjnë me reformat e analizuara,
  - Dokumente të tjera përkatëse.
- ▶ Të zbatojë një proces konsultimi me palët e interesuara relevante, duke përdorur metodën e duhur të konsultimit (intervista, forume, panele, pyetësorë, etj.);
- ▶ Të përgatitet një listë me 10-20 reforma të propozuara që do të zbatohen në ekonomitë e tjera;
- ▶ Të zgjedhë 3-5 reforma nga lista në marrëveshje me sekretariatit teknik dhe NALED.
- ▶ Të përgatisë prospekte me 3-5 reforma të propozuara në përputhje me Doracakun (Doracakun do ta përgatisë dhe do ta sigurojë eksperti kryesor i politikave).

**Numri total i ditëve: 8**

#### Detyra 2: Përgatitja e drafteve të reformave

- ▶ Të përgatisë draft me 1-3 reforma që do të futen në ekonominë përkatëse në përputhje me Doracakun;
- ▶ Të marrë pjesë në mënyrë aktive në tryezën e rumbullakët me palët e interesuara relevante të organizuar nga ana e sekretariatit teknik.

**Numri total i ditëve: 7**

#### Detyra 3: Procesi i avokimit

- ▶ Të marrë pjesë në konferenca dhe ngjarje të tjera të avokimit, të përgatisë prezantime dhe materiale të tjera për të prezantuar gjetjet e reformave të praktikës më të mirë që duhet të "importohen" nga ekonomi të tjera, duke përfshirë edhe letrën (shkresën) për ministrinë/të për të filluar dialogun e avokimit për zbatimin e reformave;
- ▶ Të hartojë raport për rezultatet e konsultimeve.

**Numri total i ditëve: 5**

Për kryerjen e detyrave, eksperti do të shfrytëzojë **gjithsej deri në 20 ditë pune.**

### 3. Korniza e pritur kohore

Eksperti pritët t'i kryejë detyrat në kornizën kohore që vijon:

Kryerja e detyrave	Data
<b>Kryerja e detyrës 1:</b> Raport për hulumtimin e zbatuar në zyrë, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, listën me 10-20 reforma dhe broshurat reformuese (prospekt) për 3-5 reforma identifikuar.	15 gusht 2023
<b>Kryerja e detyrës 2:</b> Draft për 1-3 reforma	30 shtator 2023
<b>Kryerja e detyrës 3:</b> Raport për procesin e zbatuar të avokimit	30 dhjetor 2023

### 4. Metodologjia

Gjatë kryerjes së detyrave të tij, eksperti do të jetë i detyruar të zbatojë udhëzimet metodologjike të dhëna nga eksperti kryesor i politikave, të cilat përbëhen nga hapa metodologjikë për procedurat që duhet të ndërmerren gjatë identifikimit të reformave të praktikave dhe standardeve më të mira që do të përdoren gjatë vlerësimit të reformave. Së fundi, udhëzimet metodologjike sigurojnë format në të cilat duhet të prezantohen gjetjet. Në komunikim me ekspertin kryesor të politikave, metodologjia mund të përshtatet sipas karakteristikave specifike të ekonomisë dhe reformave të analizuara.

#### Detyra 1:

Gjatë identifikimit të reformave të praktikave më të mira, eksperti:

- ▶ Do të dorëzojë planin e zbatimit të vlerësimit hap pas hapi;
- ▶ Do të zbatojë hulumtim të detajuar në zyrë që përbëhet nga analiza e dokumenteve dhe rezulton me të dhëna për reformat që duhet të analizohen në fazat më të vonshme të vlerësimit;
- ▶ Do të zbatojë një proces të konsultimeve me palët e interesuara relevante me qëllim që të mblidhen prova për karakteristikat e reformave;

Gjatë analizimit të reformave të praktikës më të mirë, eksperti:

- ▶ Do të bëjë një analizë shumë-kriteresh, duke krahasuar reformat e ndryshme dhe duke renditur rëndësinë e tyre, duke përdorur njëkohësisht kritere vlerësimi. Kriteret e vlerësimit që do të përdoren janë:
  - Vëllimi i reformave,
  - Ndikimi,
  - Intensiteti i resurseve,
  - Efikasiteti i kohës,
  - Rritja e konkurrencës,
  - Kontributi në procesin e anëtarësimit në BE (aty ku është e aplikueshme).
- ▶ Do të hartojë 10-20 broshura për reforma në përputhje me udhëzimet metodologjike të siguruar nga eksperti kryesor i politikave.

## **Detyra 2:**

Në fazën e raportimit të vlerësimit, eksperti:

- ▶ Do të marrë pjesë në ngjarjet koordinuese në kuadër të rrjetit BP6 dhe ngjarjet e avokimit,
- ▶ Do të përgatisë prezantime dhe materiale të tjera informative për gjetjet,
- ▶ Do të prezantojë gjetjet në formë të një raporti përfundimtar (prezantimi i gjetjeve shumë-kriteresh),
- ▶ Do të përgatisë 1-3 drafte reformash në përputhje me metodologjinë e përshkruar nga Eksperti kryesor ligjor për një ambient të favorshëm biznesi,
- ▶ Do të përgatisë një letër (duke theksuar karakteristikat e reformave të përzgjedhura) duke angazhuar evokimin me Ministrinë/organin tjetër publik që është organi udhëheqës për zbatimin e reformave të përzgjedhura,
- ▶ Do të marrë pjesë në procesin e avokimit të reformave.

## **Detyra 3: Raport për procesin e zbatuar të evokimit**

Raporti përfundimtar do të duhet të prezantohet në formatin që vijon:

- Përmbledhje ekzekutive, duke përmbledhur gjetjet kryesore,
- Gjetje që rezultojnë nga procesi i avokimit,
  - Si u krye avokimi,
  - Kush u përfaqësua dhe me çfarë metodash,
  - Cilat janë rezultatet kryesore dhe cilat janë hapat e ardhshëm.
- Përfundimet dhe mësimet e nxjerra.

Përdorimi i vizualizimit dhe grafikëve të informacioneve rekomandohet enkas në fazën e raportimit dhe duhet të përfshihen në raportin përfundimtar.

Të gjitha raportet do të përgatiten në anglisht.

## **5. Kohëzgjatja e angazhimit**

Eksperti do të angazhohet deri në fund të vitit 2023.

## **6. Përvoja dhe kualifikimet**

Përvoja dhe kualifikimet që nevojiten për vendin e punës janë këto që vijojnë:

- ▶ Diplomë universitare nga sfera e ekonomisë, drejtësisë, shkencave politike, administratës publike ose sfera përkatëse; të paktën përvoja 10 vjeçare profesionale relevante mund të kompensojë mungesën e një diplome përkatëse;
- ▶ Diplomë për një shkallë më të lartë të arsimit universitar (magjistër) do të konsiderohet përparësi;
- ▶ Së paku 7 vjet përvojë të përgjithshme;
- ▶ Së paku 5 vjet përvojë pune në analizë dhe reformë të politikave publike, zbatim të analizave të politikave dhe zbatim të reformave; në reformat ekonomike dhe politikat që lidhen me ambientin e biznesit do të konsideroheshin si përparësi;
- ▶ Përvojë e dëshmuar në krijimin dhe zbatimin e reformave;
- ▶ Nevojitet përvojë në sferën e bashkëpunimit me përfaqësues të qeverisë;
- ▶ Përvojë me metoda, mjete dhe teknika hulumtuese kuantitative dhe kualitative,
- ▶ Aftësi analitike;
- ▶ Nevojitet njohja e gjuhës angleze dhe e gjuhës lokale në formë të shkruar dhe të folur.

## 7. Pagesat

Eksperti do të paguhet pas përfundimit të çdo detyre, miratimit të dërgesave të shërbimeve nga ana e sekretariatit teknik dhe kornizës së prezantuar dhe të miratuar kohore.

Në rast udhëtimi, shpenzimet e akomodimit do të mbulohen nga ana e sekretariatit teknik. Shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen me 0.2 Euro për km.

## 8. Dorëzimi i ofertës dhe persona për kontakt

Ofertuesi duhet të dorëzojë CV-në e tij dhe formularin e aplikimit me një bruto kompensim ditor të specifikuar qartë, më së voni deri më **\_\_03 korrik, 2023**, në adresën e postës elektronike: [contact@zels.org.mk](mailto:contact@zels.org.mk).

Nëse ofertuesi është person juridik, ai është i detyruar të dorëzojë dëshminë e regjistrimit nga organi për regjistrat e biznesit.

Për informacione shtesë, ju lutemi kontaktoni Ivana Serafimova, e-mail: [ivana.serafimova@zels.org.mk](mailto:ivana.serafimova@zels.org.mk), 071 351731, 02 3099033 nb.131.